

PROBLEMET QË DUHEN ADRESUAR:

- Dieta të varfra dhe ushqyerja e pamjaftueshme që ndikojnë në statusin e ushqyerjes, shëndetin dhe të mësuarit e nxënësve
- Aksesit i kufizuar në treg nga fermerët e vegjël dhe familjarët, veçanërisht gratë dhe organizimi i dobët i fermerëve
- Njohuri dhe praktika të limituara mbi dietat dhe stilet e shëndetshme të jetesës, si dhe mënyrat për të pasur dieta me vlera ushqyese të ekuilibruara
- Njohuri dhe aftësi joadekuate të mësuesve dhe prindërve për të promovuar ushqyerjen e mirë, gatimin dhe aftësitë e kopshtarisë
- Mungesa e përvojës së mësimdhënies dhe materialeve mbështetëse për të lidhur edukimin e të ushqyerit me ushqimet shkollore, kopshtarinë e shkollës, diversitetin dietik dhe sigurinë ushqimore
- Mungesa e kornizës legislative adekuate dhe infrastrukturës shkollore për të mundësuar ushqim në shkollë, edukim mbi ushqyerjen dhe kopshtarinë.

PËRSE NDËRMERRET “PROGRAMI I USHQIMIT NË SHKOLLA”?

Përmirësimi i dietave dhe mirëqenia ushqimore është çelësi për zhvillimin e fëmijës. Ushqimi i mirë kontribuon në reduktimin e varfërisë, shkak themelor i kequshqyerjes. Ai mbron dhe përmirëson shëndetin e fëmijës, inkurajon dhe u mundëson fëmijëve të ndjekin shkollën dhe të kenë performancë të mirë duke përmirësuar kështu aftësinë e tyre për të arritur potencial të plotë fizik, njohës dhe produktiv.

Me shkollën si qendër e një komuniteti më të gjerë, si shkaqet e menjëhershme dhe themelore të dietave dhe të ushqyerit të dobët mund të adresohen nëpërmjet përfshirjes së gjithë komunitetit të shkollës, familjeve, prodhuesve vendas dhe qeverisë lokale.

PROGRAMI I USHQIMIT NË SHKOLLA



**Projekt Pilot
që Mbështet Zhvillimin e
Programit Kombëtar të
Ushqyerjes dhe Ushqimin në
Shkollë në Shqipëri**

PËRMBLEDHJA E PROJEKTIT

Projekti do të kontribuojë në përmirësimin e sigurisë ushqimore, dietat, të ushqyerit dhe suksesin arsimor të nxënësve shqiptarë, duke rritur gjithashtu sigurinë ushqimore dhe ekonominë e prodhuesve vendas të ushqimeve dhe produkteve bujqësore. Duke përdorur një qasje shumë-sektoriale dhe të integruar të sistemeve të ushqimit dhe ushqyerjes në shkolla, projekti do të zhvillojë dhe testojë disa modele në shkollat fillore të përzgjedhura, të cilat mund të sigurojnë bazën për zhvillimin e një programi të qëndrueshëm ushqimi në Shqipëri.

Zbatimi i projektit do të kontribuojë në arritjen e angazhimit të Shqipërisë në Deklaratën e Romës mbi të ushqyerit dhe në zbatimin e rekomandimeve të Kornizës ICN2 për Veprim, Axtenda 2030 për Zhvillimin e Qëndrueshëm dhe është pjesë e Dekadës së Veprimit mbi të Ushqyerit të OKB.



PËRFITUESIT

Përfituesit primarë:

- Nxënësit (klasat 1-9) në shkollat fillore publike të përzgjedhura në zonat urbane dhe rurale

- Fermerët lokalë

Përfituesit dytësorë:

- Stafi i shkollës
- Familjet dhe komunitetet përreth shkollave pilot pjesëmarrëse
- Pushteti Vendor
- Shoqëria në përgjithësi

METODOLOGJIA DHE MODELET

- Qasja shumë-sektoriale dhe e integruar e sistemit ushqimor
- Zgjedhja e shkollave pilot si në zonat urbane dhe rurale
- Mbulimi universal i nxënësve në të gjitha shkollat pilot
- Ngritja prane shkollave pilot e ekonomive ndihmese për kultivimin e produkte të fresketa
- Kuzhinat e shkollave përshtaten ose përmirësohen në disa nga shkollat pilot
- Mundësimi i vakteve ose ushqime të lehta nëpërmjet kateringut në disa shkolla pilot (pa kuzhinë)
- Sigurimi i lendeve të para/ingredienteve bujqësore nga prodhues lokal (mundësisht të pastra/organike)
- Blerja e produkteve nga fermerat e vogla dhe familjare



Food and Agriculture Organization
of the United Nations

AKTIVITETET KRYESORE

1. Identifikimi i shkollave pilot për të testuar modelet që sigurojnë ushqim dhe të ngrënit shëndetshëm në shkollë
2. Rekomandimi i përditësimeve përkatëse për kuadrin ligjor mbi ushqimin dhe të ngrënit shëndetshëm në shkollë
3. Përmirësimi/ ndërtimi i kuzhinave në shkolla, objekteve të magazinimit dhe infrastrukturës të nevojshme për ofrimin e ushqimit në shkolla dhe një mjedis të pastër dhe mbështetës arsimor
4. Identifikimi, organizimi dhe zhvillimi i kapacitetit të fermerëve të vegjël lokal dhe aktorëve të tjerë në sektorin bujqësor si furnizues potencial të ushqimit në shkolla
5. Identifikimi i kapaciteteve dhe boshllëqeve të legjislacionit dhe testimi i modeleve të prokurimit publik për ofrimin e vakteve të shëndetshme në shkollë ose ushqimeve të lidhura me sektorin e vogël lokal të produkteve bujqësore
6. Ofrimi i edukimit për ushqimin, shëndetin dhe të ngrënit shëndetshëm përmes përmirësimit të kurrikulave, kopshtarisë shkollore dhe gatimit dhe aktiviteteve të tjera mbështetëse
7. Përfshirja në mënyrë aktive e familjeve, personelit të shkollës, komunitetet, shoqërisë civile, sektorit privat dhe qeverisë lokale e qendrore.

PARTNERËT:

1. Ministritë e linjës
2. Institucionet kombëtare
3. Qeverisja dhe autoritetet lokale
4. Përfituesit e projektit: nxënësit dhe familjet e tyre, administratorët e shkollave dhe personeli
5. Fermerët lokal
6. Organizatat e shoqërisë civile
7. Përfaqësues të mundshëm nga sektori privat
8. Anëtarët e komunitetit dhe palëtë interesuara
9. Agjencitë e Kombeve të Bashkuara me përvojë teknike dhe në terren në Shqipëri